

KËRKESË

Kërkuesi: Shefqet Xhukellari, i biri i Aliut e Adevies, lindur dhe banues në Vërdovë të Pogradecit.

Objekti: Shpalljen të vdekur të shtetasit Artan Shefqet Xhukellari, i biri i Shefqetit dhe Fidaries, lindur në Vërdovë të Pogradecit më 9.7.1967.

Në fund të vitit 1992, Artani së bashku me dy shokët e tij Bashkim Hamdi Latifllari dhe Fatos Aqif Latifllari është nisur malit për në Greqi. Atje ka punuar rreth katër vjet në qytetin Volos së bashku me vëllanë e tij, Besnikun. Në muajin qershor 1999, Artani ka njoftuar në telefon se do të

kthehej në Shqipëri bashkë me të vëllanë. Rugës për në Atdhe kanë kaluar maleve pasi kishin shumë dhrahmi me vete. Artani ka rrëshqitur dhe ka rënë në një humnerë të thellë maleve të Greqisë. Besniku ka njoftuar policinë greke, po pas kërkimeve të shumta nuk u gjend trupi i Artanit.

Kanë kaluar më shumë se dy vjet nga kjo fatkeqësi dhe nuk kemi asnjë të dhënë për të, prandaj kërkojmë shpalljen e tij të vdekur.

KËRKUESI
Shefqet Xhukellari